



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MAT

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

**SHPALLJE PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË
KATEGORINË E ULËT DREJTUESE,
LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË DHE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit Territorit dhe Pronës
Niveli i diplomës: Master Shkencor në Shkenca Juridike, Inxhinieri Ndërtimi,
Mjedisi dhe Agronomi

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Bashkinë Mat shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë në shërbimin civil për pozicionin:

Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit Territorit dhe Pronës
Kategoria e pagës III-2

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë në shërbimin civil.

Për të tre procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

**Afati për dorëzimin e dokumenteve për
LËVIZJE PARALELE:**

31.07.2025

**Afati për dorëzimin e dokumenteve për
NGRITJE NË DETYRË DHE APLIKIMI
NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL:**

05.08.2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Menaxhon dhe koordinon punën në tërësi të sektorit;
2. Ndjek dhe evidenton në bashkëpunim edhe me sektorët apo njësitë e tjera organizative përditësimin e akteve ligjore dhe nënligjore në përputhje me veprimtarinë e Bashkisë, në përshtatje me rregulloren dhe aktet e tjera nënligjore të saj;
3. Siguron arritjen e qëllimeve dhe misionit të Sektorit;
4. Bën interpretime ligjore, jep mendime dhe sugjerime, në rastet kur i kërkohet nga eprorët ose strukturat e tjera të Bashkisë, në lidhje me fushën e kompetencës që mbulon sektori, si kontrolli i territori dhe pronat;
5. Organizon punën brenda sektori dhe përfaqëson institucionin në procese dhe procedura, që kanë të bëjnë me institucionin e bashkisë në kuadër të fushës së kompetencës së sektorit që drejton;
6. Është përgjegjës për dhënien e këshillave, udhëzimeve dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore në fushën e kontrollit të territorit dhe pronave, më qëllim zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi;
7. Mbikqyr, kontrollon dhe harton akte në bashkëpunim me vartësit dhe eprorët në fushën e kompetencës së tij, si dhe siguron dhe kryen përfaqësimin me palët e tjera, si këshilli bashkiak, institucione të ndryshme, etj.
8. Është përgjegjës për kryerjen në kohë dhe me cilësi të inspektimit të dosjeve dhe raportimin, në përputhje me legjislacionin;
9. Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (III-2);
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë një diplomë Master Shkencor në Shkenca Juridike, Inxhinieri Ndërtimi, Mjedisit dhe Agronomi. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.
- c- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

d- Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj.

1.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
 - b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
 - c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
 - g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
 - h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi.
 - i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë Mat brenda datës 31.07.2025.

1.3

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 05.08.2025, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në Bashkinë Mat do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Mat (nëse është e mundur teknikisht) dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mat, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos kualifikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, si Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- b- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- c- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- d- Njohuritë mbi ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- e- Njohuritë mbi ligjin Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- f- Njohuritë mbi ligjin nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;

- g- Ligji nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i azhurnuar me ligjin nr.12.06.2006 dhe ligjin nr.23.07.2007;
- h- Ligji nr.11/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”;
- i- Ligji nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthim dhe kompensimin e pronës” i azhurnuar me ligjin nr.47/2015, datë 07.05.2015;
- j- VKM nr.614, datë 07.07.2015 “Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyer në fond banese, me vendime të organeve të qeverisjes vendore, në pronësi të njërive të qeverisjes vendore dhe të shtetit, ku janë sistemuar me strehim banorë të pajisur me autorizim nga organet kompetente”;
- k- VKM nr.578, datë 29.08.2018 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”;
- l- Ligji 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- m- Njohuritë mbi ligjin nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar;
- n- Ligjin nr.7501 datë “Për Tokën” i ndryshuar;
- o- Ligjin nr.8752 datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturës për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”;
- p- Ligjin nr.8312 datë 26.03.1998 “Për Tokën Bujqësore të Pandarë” ;
- q- Ligjin nr.9244 datë 17.06.2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”;
- r- Ligjin nr.9948 datë 07.07.2008 ‘Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”;
- s- Ligjin nr.10440, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”;
- t- Ligji për “Shpalljen e Moratoriumit të Fondit Pyjor në Republikën e Shqipërisë”;
- u- Ligji për “Administrimin e Fondit Pyjor dhe Kullosor Kombëtar në Republikën e Shqipërisë”;
- v- Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar;
- w- Ligji Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”;
- x- Ligji Nr. 9780, datë 16.7.2007
- y- Ligji Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar;
- z- Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURRIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mat do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Mat (nëse do të jetë e mundur teknikisht) dhe stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2

NGRITJA NË DETYRË DHE PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Kjo procedurë është vendosur të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lirë (në zbatim të vendimit të titullarit por që nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik, neni 26/4). Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të Bashkisë Mat dhe stendat e informimit të publikut duke filluar nga data 05.08.2025.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë IV-3;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master shkencor”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë një diplomë Master Shkencor në Shkenca Juridike, Inxhinieri Ndërtimi, Mjedisë dhe Agronomi. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit.
- c- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d- Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj.

2.2

KRITERET E VEÇANTA QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT QË APLIKOJNË NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

Kandidatët nga jashtë shërbimit civil duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë një diplomë Master Shkencor në Shkenca Juridike, Inxhinieri Ndërtimi, Mjedisë. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.
- c- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d- Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj.
- e- Kërkesat për pranimin në Shërbimin Civil sipas nenit 21 të Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”.

2.3 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- a- Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet për konkurrim, të listuara në pikën 1.2.
- b- Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë Mat brenda datës 05.08.2025

2.4 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 15.08.2025, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mat do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë (nëse është e mundur teknikisht) dhe standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos kualifikimit.

2.5 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.6 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.7 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mat, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.